

V E N D I M

Nr. 84 Date 17.07. 2008

**PER
LICENSIMIN E SHOQERISE “E-VENTO S.R.L ALBANIA” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa a, 8, si dhe 15 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, neneve 5, 13 si dhe 14, te “Rregullores per Procedurat e Licensimit” te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21, datë 04.04.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.07.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k, per tu licensuar ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimin e energjise elektrike,


Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave per shqyrtimin e aplikimit te “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr. 51 date 09.05.2008.
2. Ligji nr. 9913, date 5.5.2008 ” Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nuk parashikon te kete fuqi prapavepruese per aplikimet e paraqitura para hyrjes ne fuqi te ketij ligji.
3. Ne lidhje me ndertimin e ketij parku, shoqeria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k, aplikimin e saj per tu licensuar ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjise elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit ne te dhena historike te rregjistruara te eres, te matura ne lartesi te ndryshme nga nga ato ne te cilat do te punojne gjeneratorenet.
4. Ligji per Sektorin e Energjise Elektrike parashikon ne nenin 15 autoritetin e ERE-s per vendosjen e kushteve te çdo license

Per sa konstatuar, Bordi i Komisionereve te ERE-s,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve




Vendosi:

1. Të licensoj shoqerine “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimin e energjise elektrike prej tyre me kusht zbatimin pervec sa parashikuar ne licensen tip te miratuar nga Bordi i Komisionereve per aktivitetin e ndertimit dhe prodhimin te energjise elektrike, edhe te zbatimit te kushteve te meposhteme:
 - a. Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtezohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Percaktimi në këtë studim i koshtes së prodhimin të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e leshimit te licenses dhe perpara fillimit te zbatimit te punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.
 - b. Shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k duhet paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nenshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjellta, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.
 - c. Shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k, do të respektojë detyrimet e Shërbimit Publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
 - d. Koha e zbatimit e te gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke ju referuar datës së leshimit të licencës të jetë 36 muaj.
 - e. Mospermbushja e pikave te mesiperme ne afatet e percaktuara e ben licensen te pavlefshme.
2. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komsionereve te ERE-s,

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN
Nr. __ date 17.07.2008

PER
LICENSIMIN E SHOQERISE "E-VENTO S.R.L ALBANIA" SH.P.K

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|--------------------------|-------|--------|
| Bujar Nepravishta | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |